UDHËZIM
Nr. 18, datë 12.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 11/1, DATË 15.4.2015 "PËR BOTIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016"

Në mbështetje të neneve 45 dhe 47 të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010 "Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 11/1, datë 15.4.2015 "Për botimin e teksteve shkollore të reja për vitin shkollor 2015-2016", të ndryshuar, afatet kohore të zhvillimit të konkursit, të parashikuara në pikën I, të ndryshojnë si më poshtë:

"I.3 AFATET KOHORE TË ZHVILLIMIT TË KONKURSIT

Shpallja e konkurrimit:	20 prill 2015;
Dorëzimi i teksteve shkollore:	1 korrik 2015;
Shpallja e fituesve:	15 korrik 2015;
Përzgjedhja nga mësuesit:	31 korrik -7 gusht 2015;
Shpërndarja dhe shitja e teksteve:	1 shtator -13 shtator 2015. ".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Komisioni i Vlerësimit të Teksteve në MAS.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE I SPORTIT
Lindita Nikolla